



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 si dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.11/120 të datës 14.12.2016, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM
PËR KOMPENZIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NË BUJQËSI NGA FATKEQËSITË E
NDRYSHME NATYRORE

Neni 1

TË KOMPENZOHEN, dëmet e shkaktuara në bujqësi nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore në tërë territorin e Komunës së Lipjanit, për vitin 2016, sipas regjistrit të propozuar nga Komisioni për vlerësimin e dëmeve në bujqësi që kap shumën 22,292 Euro, konform Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.11/120 të datës 14.12.2016 si dhe 1200 euro të mbetura nga mjetet e dedikuara paraprakisht për kompensimin e dëmeve nga vërshimet në bujqësi konform Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.06/83 të datës 06.04.2016 që kap shumën e terësishme në vlerë prej 23492,00 Euro.

Neni 2

Kompensimi i dëmeve do të bëhet nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere të Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, mjete këto të dedikuara për qëllimin e cekur në nenin 1, konform Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.11/120 të datës 14.12.2016 në xhironlogaritë bankare të përfituesve individual sipas regjistrit të propozuar nga Komisioni për vlerësimin e dëmeve në bujqësi

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti i dorëzohet për zbatim Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

1Nr. 400-69106
Lipjan, më 21.12.2016

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti